

Men Care:

Fushata globale për promovimin e etërve më të barabartë dhe më të angazhuar

Bebai më i
MIRË



MenCare



SEPSE PËRAFËRSISHT 4 NGA 5 BURRA
NË MBARË BOTËN DO TË BËHEN ETËR
NË NJË PIKË TË JETËS SË TYRE.

Men Care:

Fushata globale për promovimin e etërve më të barabartë dhe më të angazhuar

Care International Balkans dhe rrjeti i organizatave partnere të Care-it në Ballkan i është bashkangjitur fushatës globale për atësinë MenCare, që koordinohet nga Promundo dhe Sonke Gender Justice Network.

MenCare është fushatë globale për të promovuar përfshirjen e burrave si etër dhe kujdestarë të drejtë, përgjegjës dhe jo të dhunshëm. Fushata ofron porosi cilësore për komunitetin dhe masmediat, asistencë teknike dhe trajnime, rekomandime rreth politikave dhe programeve dhe të dhëna për përkrahje të OJQ-ve, organizatave për të drejtat e grave, qeverive dhe partnerëve të Kombeve të Bashkuara në përpjekjet e tyre për të përfshirë burrat dhe djemtë në përkujdesje¹.

MenCare ka fushata aktive dhe aktivitete të vazhdueshme në afro **25 vende ne 5 kontinente** për momentin.

25



5



¹ Përkujdesje (ang. Caregiving) nënkupton përfshirjen apo angazhimin e një individi, prindi, apo kryefamiljari që të kujdeset për nevojat e një fëmije apo një të rrituri të varur.

*Jam me fat që
të kam **ty baba***

Babai më i
MIRË



Pse kjo fushatë?

Përafërsisht katër nga pesë burra në të gjithë botën do të bëhen etër në një pikë të jetës së tyre. Dhe gati të gjithë burrat e botës kanë njëfarë raporti me fëmijët, qoftë si njerik, vëlla, xhaxha, gjysh, mësues, mentor, trajner, apo thjeshtë si shok.

Një numër i madh dëshmish në rritje e sipër nga Global South dhe Global North konfirmon që përfshirja e burrave dhe etërve të përgjegjshëm në jetën e fëmijëve është pozitive për fëmijët, për gratë dhe për vet burrat.

Në nivel global, gratë dhe vajzat vazhdojnë të mbajnë barrën kryesore të punëve të shtëpisë, edhe pse ato përfaqësojnë 40% të fuqisë së paguar punëtore. Pjesëmarrja e kufizuar e burrave në përkujdesje (përkujdesje të fëmijëve dhe për të tjerët në familje) vazhdon të jetë pengesë kryesore e barazisë gjinore dhe e fuqizimit të grave, duke i mbajtur të ardhurat e grave më të ulëta sesa të burrave.

MenCare është plotësues shumë i nevojshëm i përpjekjeve globale dhe lokale për t'i përfshirë burrat dhe djemtë për t'i dhënë fund dhunës kundër grave dhe fëmijëve. Është pjesë e vizionit global të Men Engage Alliance për të krijuar raporte të drejta dhe jo-të dhunshme, dhe perspektivat e përkujdesjes si pjesë e të qenit burrë. Partnerët e MenCare përpiqen të luftojnë në bashkëpunim me organizatat e drejtave të grave – dhe direkt me gratë dhe nënat, sikurse edhe me burrat – për të identifikuar dhe promovuar përkujdesje me përgjegjësi të përbashkët, jo të dhunshme dhe me norma të barabarta gjinore, si dhe lindje të sigurt.

Temat kryesore

MenCare ka 10 tema si shtylla të fushatës globale MenCare. Në Ballkan, fushata jonë për atësi si pjesë e hapave të saj të parë do të fokusohet në promovimin e imazheve pozitive të atësisë dhe përkujdesjes në jetën e përditshme të një fëmije. Përgjatë zhvillimit të fushatës, ne do të fokusohemi në tema të tjera të rëndësishme sikurse: përfshirja e etërve në përkujdesjen ditore, edukim, shëndetin e fëmijëve dhe parandalimin e dhunës.

Tri temat e para të fushatës janë si në vijim:



1. BËHU KRENAR & DËSHMOJE

Ti mund të jesh burrë që respektohesh nga familja dhe komuniteti. Është e lehtë ... vetëm bëhu babë krenar.

Shpesh të vetmin rol që e njeh dhe e pranon shoqëria për burrat është ai i kryefamiljarit apo të atij që 'e mban familjen'. Por shoqëritë dhe familjet po ashtu i duan dhe i respektojnë burrat që janë **etër të angazhuar**.

Burrat që kultivojnë marrëdhënie të afërta dhe të kujdesshme me fëmijët e tyre – pavarësisht identiteteve të tyre seksuale apo pavarësisht nëse jetojnë me nënën e fëmijës së tyre – janë më të mirë në shumë mënyra.

2

2. VETËM LUAJ

Loja është biznes serioz. Gjej kohë për të qeshur dhe luajtur çdo ditë.

Gati gjysma e etërve në të gjithë botës thonë që ata në një mënyrë apo tjetrën përkujdesen për fëmijët e tyre në bazë ditore. Aktiviteti më i zakonshëm ditor që burrat bëjnë me fëmijët e tyre është loja. Të luash me fëmijët është shumë me rëndësi jo vetëm për shkak të argëtimit por edhe përkujdesit ditor, dhe kjo duhet të inkurajohet edhe më shumë. Loja është e domosdoshme sepse i ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësi motorike, të kultivojnë kreativitetin dhe shkathtësitë shoqërore. Edhe burrave u ndihmon të luajnë me fëmijët. Përmes lojës, ata lidhen me fëmijët, zhvillojnë ndjeshmërinë dhe përgjegjshmërinë për nevojat e fëmijëve.

3

3. BËHU I GUXIMSHËM – TREGO BUTËSI

E ke mundësinë të jesh baba që kujdeset thellësisht për ata që i do. Ky tipar është i rrallë në botën e sotit.

Shumë gra e burra mendojnë që burrat nuk mundën apo nuk duhet të tregojnë butësi e kujdes ndaj fëmijëve – që etërit duhet të jenë stoikë, dhe zbatues të rregullave dhe disiplinës. Por **të tregosh butësi e dashuri dhe të shfaqësh emocione dhe kujdes është kontributi më i rëndësishëm i një babai.** Fëmijët të cilët kanë lidhje të ngushta emocionale me etërit e tyre kanë më shumë prirje të tregojnë empati, të lidhen më shumë me komunitetet e tyre dhe të kenë shëndet më të mirë mendor.



Target grupet

Duke e njohur faktin që secila familje është unike dhe ka formën dhe marrëdhëniet e veta dinamike, ne kemi vendosur të kemi qasje gjithëpërfshirëse me prindërit dhe të përfshijmë përfaqësues të ndryshëm të familjes.

Target grupi parësor për nisjen e aktiviteteve të fushatës do të përbëhet nga **babai, njerku dhe ai që do të bëhet baba së shpejti**.

Më vonë, fushata do të fokusohet në të gjithë ata që përkujdesen, model të rriturish sikurse gjyshërit, trajnerët, mësimdhënësit, dhe anëtarë të tjerë të familjes.

Ne po ashtu e kuptojmë dhe vlerësojmë rëndësinë e nënave dhe rolin e tyre të rëndësishëm në jetën e fëmijëve dhe të familjes. Kjo është arsyeja pse fushata do të përfshijë nënat dhe gratë në përkujdesje.

Çfarë duam të themi?

◆ **Gjej kohë për të qenë baba**

Po është me rëndësi të mbash familjen, por duhet të gjes kohë për fëmijën tënd. Humb shumë nëse nuk e bënë këtë. Kalo kohë me fëmijën tënd, dhe bëhu baba aktiv.

◆ **Bëhu shembull për fëmijën tënd**

Bëhu baba i mirë, dhe model për të.

◆ **Ushtar dhe autoritar APO baba emocional dhe i përkushtuar**

Ambienti përreth gabimisht të mëson të jesh polic dhe autoritar, të jesh i rreptë. Shijoje atësinë, relaksohu, luaj me fëmijën tënd, trego butësi dhe shpreh ndjenja, dorëzoju lojës – këndo me fëmijën tënd në veturë edhe nëse e urren të këndosh, vallëzo me fëmijën tënd, luaj futboll me fëmijën tënd.

◆ **Mos u brengos se çka thonë njerëzit e tjerë**

Është me rëndësi se çka thotë fëmija yt dhe koha që e kalon me të; mos e humb këtë kohë cilësore.

Si do ta realizojmë këtë?

Media

Do të krijojmë dhe përshtatim materiale vizuale (postera, filma, etj) në mënyrë që të fillojmë biseda të gjëra në komunitet për variantin pozitiv të burrërisë.

Programe

Do të zhvillojmë dhe përshtatim programe për edukim grupor të etërve, kujdestarëve dhe punëtorëve të mirëqenies sociale të cilët do të kenë rol të rëndësishëm në përfshirjen e etërve në detyrat prindërore.

Avokimi

Do të avokojmë për politika që krijojnë më shumë mundësi për përfshirjen e burrave në përkujdesje, në fuqizimin ekonomik të grave, shëndetin amënor dhe mirëqenien e fëmijëve.

Babai më i
MIRË



Si t'i bashkoheni Fushatës për Etërit të Inicativës së Burrave të Rinj (ang. YMI)?

Ju lutem, kontaktoni:

CARE International Balkans in Kosovo

Gazmend Zajmi no. 21,

10 000 Prishtinë

Tel: +381 38 222 435

www.care-balkan.org

Peer Education Network

Rr. Rexhep Mala , nr 5,

38000 Prishtinë

Tel: + 381 38 223 942

<http://ngo-pen.org/>

Për më shumë informacion që lidhet me Djemtë dhe Burrat në Ndryshimin e Kontekstit Gjinator dhe Parandalimin e Dhunës në Ballkanin Perëndimor (Iniciativa e Burrave të Rinj - ang. YMI), ju lutem vizitoni: www.youngmeninitiative.net

Men Care



Austrian
 Development Cooperation

 OAK
FOUNDATION